

Raporti Vjetor 2015



*Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
Janar 2016*

Rreth Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri është një entitet joqeveritar i themeluar në 2009 si një rrjet i shoqërisë civile me qëllim për të monitoruar situatën e fëmijëve në vend. Nëpërmjet përfaqësuesve të tij në nivel rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në bashki dhe komuna, Observatori mbledh informacionin statistikor nga të dhënat administrative të shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera vendore. Duke përdorur softwerin DevInfo pasuria e informacionit statistikor është konsoliduar në një bazë të dhënash të disponueshme online në: <http://observator.org.al/odf2/qarqet-en.html>

Deri tani, baza e të dhënave të Observatorit është një burim unik i të dhënave të tilla: një ndërfaqe që lejon prezantim aktiv në specifikat e Shqipërisë në 374 bashki dhe komuna. Duke përdorur këto të dhëna të marra nga studime Observatori ka realizuar raporte për situatën dhe ka kontribuar në raportet e planeve të veprimit për fëmijët që zhvillohen në nivel kombëtar dhe rajonal. Në vitin 2013 ai prodhoi raportin e parë të plotë në dimensione të ndryshme të varfërisë dhe deprivimit të fëmijëve në Shqipëri.


Një kontribut i rendësishëm i prezencës së fortë të Observatorit në terren është aftësia e tyre për të advokuar me autoritetet qeveritare për të zgjeruar masat lokale për adresimin e nevojave të fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht me prejardhje të cënueshme. Kohët e fundit, Observatori ka qenë midis udhëheqësve të një nisme në mbarë vëndin "Çdo fëmijë rom në kopësht". Besueshmëria e tyre nga ata që "dinë" gjendjen reale ka qenë i dobishëm në rolin e mbështetësve për përfshirjen e hershme të fëmijëve Romë.

Në kuadër të diskursit të post-realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) Observatori do të vazhdojë të luajë një rol kritik të një instrumenti të pavarur të shqyrtimit për të matur përparimin e Shqipërisë drejt një shoqërie më sociale, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Kjo punë është duke u realizuar në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Statistikave (INSTAT), për të forcuar statistikat sociale, duke kuptuar që niveli i detajeve në regjistrat e Observatorit ka gjasa të mbetet një veçori unike duke plotësuar rregullisht mbledhjen e të dhënave në një nivel më të agreguar.

Për më shumë informacion rreth Observatorit, mund të kontaktoni në:

Adresa Email: info@observator.org.al

Telefon: 00355 4 22 58 987



Përmbajtja

Rreth Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve.....1

1. Projekte dhe inisiativa të zhvilluara nga Observatori gjatë vitit 2015 (Janar – Dhjetor 2015)3

I. *Martestat e fëmijëve në Shqipëri, fokusim i veçantë mbi komunitetin Rom.....3*

II. *Parandalimi i martesave të hershme në Shqipëri.....3*

III. *Mobilizimi i të rinjve për llogaridhënien e zyrtarëve publik4*

IV. *Çdo fëmijë Rom në kopësht (Viti 2).....4*

V. *Situatë përmbytjeje në rajonin e Fierit.....5*

VI. *Fushata “Zëri i të rinjve” në Shqipëri
.....**Error! Bookmark not defined.***

VII. *Pabarazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Çelësi i suksesit në politikat e ndërmarra – përfshirja e vendorve dhe rinisë.....6*

2. Kontributi Partnereve.....6

3. Përmbledhje rreth Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, gjatë këtij viti (2015).....7.



1. Projekte dhe nisma të zhvilluara nga Observatori gjatë vitit 2015 (Janar - Dhjetor 2015)

I. Martesa e fëmijëve në Shqipëri fokus i veçantë mbi komunitetin Rom

Ky studim që Observatori ka ndërmarrë është përqëndruar në martesat e hershme dhe fokusi i tij i veçantë është fenomeni i martesës së hershme në komunitetin Rom. Studimi ka qenë i fokusuar në 3 zonat pilot (Shkoza, Tufina dhe Liqeni) të cilat kanë komunitet Romë që jeton në të. Qëllimi i projektit është që të zhvillojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës për parandalimin e dhunës në familje, martesat e hershme dhe trafikimin njerëzor, duke siguruar sensibilizimin e familjes dhe komunitetit mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe njeriut me objektivin primar të komunitetit Rom. Gjatë realizimit të këtij studimi, hasëm shumë kufizime; duke filluar nga mungesa e studimeve në këtë fushë për këtë fenomen në Shqipëri, duke vazhduar me mungesën dhe përditësimin e të dhënave në procesit e shqyrtimit në tavolinë dhe pengesën kulturore të diskutimit për këtë fenomen në komunitetet Rome, të cilat kanë qenë si zona pilot në këtë nismë.



Nisma u përqëndrua në këto ndërhyrje:


- Të ndërgjegjësohet të publikut dhe shpërndarjes së informacionit në komunitetet Rome, për dëmet dhe rreziqet që ndeshin fëmijët në fazën e angazhimeve të tyre të hershme në martesë, sjelljet e dhunshme brenda familjes së tyre, të cilat mund të rezultojnë tragjikisht në rrjetin e trafikimit njerëzor.
- Të identifikoj dhe monitorojë fenomenin e dhunës në familje, martesën e hershme të fëmijëve dhe trafikun njerëzor në fushat e zbatimit të projektit.
- Të vijojë këtë iniciativë me veprime të tjera të nevojshme dhe të ndërtojë një model të ndërhyrjes që mund të përdoret në vendbanimet të tjera ku jetojnë komunitetet Rome.

II. Parandalimi i Martesave të hershme në Shqipëri

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka përgatitur studimin e dytë për "Parandalimin e martesave të hershme në Shqipëri", gjatë periudhës 1 Nëntor 2015 - 26 shkurtit 2016, një nismë e mbështetur nga Fondi Kanadez për Iniciativave Lokale. Qëllimi i projektit është të adresoj zgjerimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve për të arritur efikasitet, mbështetjen dhe referimin e rasteteve të fëmijëve dhe familjeve në situatë të veçantë cenueshmërie si martesat e hershme të detyruara.

Nisma u përqëndrua në këto ndërhyrje:

- Në rritjen e ndërgjegjësimit publik për dukurinë e martesave të hershme të detyruara të fëmijëve (MHDF), duke u fokusuar në fuqizimin e vajzave të reja dhe duke i mobilizuar familjet dhe komunitetet, në të gjitha rajonet e vendit.



- Në identifikimin dhe ndjekjen e fenomente të martesave të herëshme të detyruara tek fëmijët duke mbuluar të gjithë rajonet e Shqipërisë, duke u përqendruar kryesisht në zonat nënurbane dhe ato në zhvillim.
- Në shpërndarjen e gjetjeve të projektit dhe të gjithë procesin e përfshirë në të, me të gjitha palët lokale dhe qendrore të interesuara që kanë kontribuar përgjatë procesit të zbatimit të projektit.

III. Mobilizimi i të rinjve për llogaridhënien e zyrtarëve publikë

Observatori ka zbatuar projektin "Mobilizimi i të rinjve për llogaridhënien e zyrtarëve publikë" gjatë periudhës Prill- Dhjetor 2016, një nismë e mbështetur nga Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile.

Qëllimi i projektit është rritja e dinamikës së pjesëmarrjes së të rinjve në mënyrë që të jenë qytetarë aktiv, protagonistë të zhvillimit të tyre. Ky projekt ka ndihmuar dhe mbështetur të rinjtë (18-25 vjeç), për të marrë pjesë në mënyrë aktive në vendimmarrje, në ndërtimin e një komuniteti që zhvillon llogaridhënien e zyrtarëve publik.

Nisma u përqëndrua në këto ndërhyrje:

- Të informojë dhe sensibilizoj të rinjtë për pjesëmarrje aktive qytetare në vendimmarrje;
- Të inkurajojë debatin publik dhe dialogun politik midis kandidatëve për kryebashkiak të qeverisjes lokale dhe grupet rinore;
- Të mas perceptimet e rinisë për rolin dhe ndikimin në prioritetet e strategjisë politike të zgjedhur nga kandidati;
- Të monitoroj programin dhe përgjegjësinë e kryebashkiakëve të zgjedhur, nëse nevojat dhe prioritetet e përmendura nga të rinjtë dhe të premtuara nga kryebashkiaku (gjatë fushatës) janë të përfshira në prioritetet e politikës së tyre lokale.



IV. Çdo fëmijë Rom në kopësht (Viti 2)

Faza e dytë e nismës "Çdo fëmijë Rom në kopësht: Ndërtimi i rrjeteve advokuese dhe praktikave të bazuara në dëshmi për fëmijët Romë në zhvillimin e fëmijërisë së hershme " që synon të ngrëjë dhe mbështesë rrjetet lokale të bazuar në evidencë advokuese për zhvillimin e hershëm të fëmijëve Romë, duke punuar me shërbimet sociale (punonjës sociale) dhe institucione të tjera që sigurojnë kujdesin dhe mbrojtjen për fëmijët, OJQ-të dhe partnerë të tjerë social. Një nga fokuset kryesore të bashkëpunimit mes Qeverisë Shqiptare dhe UNICEF-it është sigurimi që fëmijët Romë dhe jo-Romë të marrin njësoj një fillim të barabartë në jetë. Kjo iniciativë është hartuar për të luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e informacionit periodik, mbledhjes së të dhënave dhe evidencave, shkëmbimit të praktikave më të mira, boshllëqeve të identifikuara dhe zbatimin e politikave të analizuara për përfshirjen e Romëve, - të cilat rezultojnë në rrugën e hartëzimit të praktikave.

Nisma përqëndrohet në ndërhyrjet e mëposhtme:



- Të lehtësojë dhe inkurajojë aleanca me autoritetet lokale, prindërit Romë, aktiviste rinore të komunitetit Rom për përfshirjen në arsimin parashkollor të fëmijëve Romë;
- Të mbledh vazhdimisht të dhëna/ evidenca/praktikat e mira dhe mangësitë e zbatimit të politikave për fëmijët Romë (bazuar në një protokoll të unifikuar për mbledhjen e të dhënave dhe evidencave);
- Të përgatis raporte periodike të monitorimi të veprimeve dhe të llojë për ndryshim e në mbështetje të përfshirjes së fëmijëve Romë në kopshte;

Kjo realizoi një listë të veprimeve që synonin përcaktimin e rolit, funksioneve dhe detyrave të institucioneve lokale në lidhje me përfshirjen sociale të hershme të fëmijëve Romë në zonën e tyre. Këto veprime janë hartuar në një rrjet rolesh dhe detyrash të aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë, duke prodhuar dhe përçar mbledhje të përhershme të të dhënave dhe evidencave, rast pas rasti zgjidhje dhe shkëmbimi i praktikave më të mira të përfituara, duke identifikuar mangësitë dhe gjetjen e zgjidhjes së duhur

V. Situatë përmbytjeje në Qarkun e Fierit


Në mbështetje të situatës kritike dhe emergjente të krijuar si pasojë e përmbytjeve në pjesën jugore të Shqipërisë, Qeveria e Kanadasë dhe Bankers Petroleum, shprehin solidaritetin e tyre në këto ditë të vështira për banorët e këtyre zonave të prekura. Qeveria e Kanadasë dhe Bankers Petroleum, në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve, siguroi mbështetje për 145 familje në komunën e Dërmenasit (fshati Povelcë dhe Darzezë), duke ofruar ndihmë humanitare sipas nevojave kryesore të identifikuar nga Prefektura Fier dhe vendosur në terren: dyshek, batanije, çarçaf dhe jastëkë në shumën prej rreth 70.000 Dollar Kanadez. Kjo ndihmë, ka për qëllim të ndihmojë në rikuperimin më të shpejtë të familjeve që jetojnë në vështirësi ekstreme në këtë situatë post- emergjente, me produkte me cilësi të lartë për ofrimin atyre të rehatisë dhe sigurisë për një periudhë të gjatë kohore. Procesi i shpërndarjes së ndihmave direkt tek familjet e prekura, është lehtësuar dhe garantuar në sajë të bashkëpunimit me Shtabin e Emergjencave Civile: në Shqipëri; Prefekturën Fier; Komunën Dërmenas, Fier.



VI. Youth Voice - E Ardhmja që duam në Shqipëri

Youth Voice fushata në Shqipëri po kryhet nga një rrjet i 11 organizatave rinore zyrtare dhe 2 grupet rinore/klube, të specializuara dhe që punojnë në fusha të ndryshme, veçanërisht me të rinjtë vulnerabel, mbështetur nga UNFPA- Shqipëri dhe e bashkërenduar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve. Organizatat janë rrjetëzuar me njëra-tjetrën dhe po zbatojnë aktivitetet e ndryshme në nivel kombëtar, në rajone të ndryshme në Shqipëri për periudhën Korrik - Nëntor 2015.

Aktivitetet e planifikuara për fushatën e këtij viti janë përqëndruar në kontaktin me vendimmarrësit dhe paraqitjen e vizionit rinor dhe



mesazheve advokuese të aktorëve kombëtarë dhe vendim-marrësve dhe advokoimit të mëtejshme për përfshirjen e tyre në planet kombëtare të veprimit dhe buxhetet.

VII. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: çelësi i suksesit në politikat e ndërmarra – përfshirja e vendorëve dhe rinisë



Observatori ka zbatuar projektin "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, çelësi i suksesit në politikat e ndërmarra - përfshirja e vendorëve dhe rinisë" gjatë periudhës Shtator 2015-Shtator 2016, një nismë e mbështetur nga UNDP dhe UN Women.

Qëllimi i projektit ishte për të ndikuar në reduktimin e dhunës në familje e me bazë gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në 2 fusha të ndryshme në Shqipëri duke angazhuar burra dhe djem në partneritet me gratë dhe vajzat si aleatë, shembuj dhe agentë të ndryshimit, duke përfshirë aktorët vendorë si dhe rininë.

Nisma përqëndrohet në ndërhyrjet e mëposhtme:

- Të përfshijë aktorët lokalë që të angazhohen dhe të jenë pro-aktive në fushatën për reduktimin e dhunës në familje e me bazë gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në Shqipëri;
- Të inkurajojë dhe mobilizoj rininë si agentë promovimi në përkrahje të reduktimit të dhunës në familje dhe promovimin e barazisë gjinore.

2. Kontributet e partnerëve

Nr.	Titulli i projektit	Periudha e zbatimit	Donatori
1.	Martesa e fëmijëve në Shqipëri, fokus të veçantë në Komunitetin Rom	Janar - Mars 2015	CFLI
2.	Parandalimi I martesave të hershme në Shqipëri	Tetor 2015 - Shkurt 2016	CFLI
3.	Mobilizimi i rinisë për llogaridhënien zyrtarëve publikë	Prill - Dhjetor 2015	AMSHC
4.	Çdo fëmijë Rom në kopësht (Viti II)	Prill 2015 - Maj 2016	UNICEF
5.	Situatë përmbajtjeje në Qarkun e Fierit	Shkurt 2015	CFLI
6.	Youth Voice- e ardhmja që duam në Shqipëri	Korrik - Dhjetor 2015	UNFPA

7.	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: çelësi i suksesit në politikat e ndërmarra – përfshirja e vendorëve dhe rinisë	Shtator 2015-Shtator2016	UN Women
----	--	--------------------------	----------

3. Vlerësime rreth Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, gjatë këtij viti (2015)

"Observatori duket të jetë një organizatë e respektuar, me kontakte të mira dhe me zyra të ngritura në mbarë vendin, duke arritur në target grupe të moshave të ndryshme, veçanërisht më vulnerabilet dhe të rinjtë. Puna e kryer nga ata ka qënë një kontribut i vlefshëm për ngritjen e vetëdijes në mesin e komuniteteve dhe grupeve të të rinjve, si dhe ndjekja dhe monitorimi i çështjeve që dalin e adresimi i tyre tek qeveritë lokale e shoqëria civile që veprojnë në këtë fushë. Observatori vazhdimisht ka demonstruar një qasje shumë korrekte dhe të përgjegjshme në punën me UNFPA" **Znj. Manuela Bello Ndhmës Përfaqësuese e UNFPA Shqipëri**

"Kontributi dhe angazhimi i Observatorit për mbështetjen e fushatës dhe si partner në aktivitetet dhe iniciativat rajonale të #HeForShe është çelësi për arritjen e audiences së targetuar duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të barabartë, pa dallim gjinie dhe dhunës mbi baza gjinore" **Z. David Sanders, përfaqësues i UN Women në Shqipëri**

"Ne e vlerësojmë dhe çmojmë përkushtimin e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, ndihmën tuaj konkrete si në aspektin moral dhe material, për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë dhe përballimin e situatës emergjente të krijuar në Qarkun e Fierit" **Z. Xhevit Bushaj Prefekti i Qarkut Fier**